

I. Struktura Organizative e UPT

Universiteti Politeknik i Tiranës përbëhet nga njesitë si më poshtë:

Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike

Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit

Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës

Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike

Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave

Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike

Instituti i Gjeoshkencave Energjisë Ujit dhe Mjedisit

II. Të dhënat për arsimin, kualifikimin dhe pagat e funksionarëve të cilët sipas ligjit kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë në UPT.

Mbështetur në ligjin nr.9049, datë 10.04 2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të nëpunësve publik”, dhe në ligjin nr. 9367 date 7.4 2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave gjatë ushtrimit të institucioneve publike”, dy zyrtaret të cilët kanë detyrim për Deklarimin e interesave private periodik/vjetor janë:

- Z.Jorgaq Kacani, Rektor i Universitetit Politeknik të Tiranës, ka përfunduar studimet për Inxhinieri Mekanike dhe mban titullin Akademik. Ka kryer shumë kualifikime dhe specializime jashtë vendit si Itali, SHBA, Angli, Francë dhe Gjermani. Paguhet me pagën sipas lidhjes nr. 1 të VKM nr. 507 datë 1.8.2012 “Për disa ndryshime në VKM nr. 748 datë 11.6 2009 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë” me pagën e pozicionit “Rektor”.
- Z.Besmir Ali, Kancelar i Universitetit Politeknik të Tiranës, ka përfunduar studimet në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, posedues i titullit “Avokat” që nga viti 2011, vazhdon studimet në ciklin e dytë Master Profesional për Administrim Publik me kohë të pjesshme në Fakultetin e Ekonomisë në Univeristein e Tiranës. Paguhet me pagën sipas lidhjes nr. II të VKM nr. 589 datë 17.7.2013 “Për disa ndryshime në VKM nr. 545 datë 11.8. 1011 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabinetit, në kryeministri, aparatet e ministrave të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, prokurorinë e përgjithshme, gjykatën e lartë, disa institucioneve të pavarura,

institucione në varësi të kryeministrit dhe administratën e perfektit”, të ndryshuar, kategoria II-b.

III. Struktura e pagave për punonjësit e tjerë:

Në Universitetin Politeknik të Tiranës ka tre kategori punonjësish:

- Personeli akademik paguhet sipas lidhjes nr. 1 të VKM nr. 507 datë 1.8.2012 “Për disa ndryshime në VKM nr. 748 datë 11.6 2009 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar.
- Personeli administrativ, të cilët me pagën sipas lidhjes nr. II të VKM nr. 589 datë 17.7.2013 “Për disa ndryshime në VKM nr. 545 datë 11.8. 1011 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabinetit, në kryeministri, aparatet e ministrave të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, prokurorinë e përgjithshme, gjykatën e lartë, disa institucioneve të pavarura, institucione në varësi të kryeministrit dhe administratën e perfektit”, të ndryshuar dhe konkretisht:

Kancelari II-b

Drejtorët III-a

Kryetari Degës III-b

Specialist IV-a

- Punonjës mbështetës, të cilët paguhet sipas lidhjes II të VKM nr. 610 datë 24.7.2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 717 datë 23.6 2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore”, të ndryshuar.